



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_03.2023

**MBLEDHJA Nr. 15,**  
**Datë 27.03.2023, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 27.03.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 15 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e OST sh.a. për intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues dhe nominimeve të transaksioneve tregtare
2. Mbi licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës
3. Mbi licencimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2100 kW
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “EU Green Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Parku Eolik i Erës “Dropulli Wind”, me kapacitet të instaluar 20 MW, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastrë
5. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.06.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kW, “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kW, dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kW, me kapacitet total të instaluar 5675 kW”, i ndryshuar
6. Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike
7. Mbi miratimin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

